



INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH PSSA-SË

Cilat shkolla marrin pjesë?

Në testime marrin pjesë të gjitha shkollat e drejtorisë arsimore dhe shkollat charter. Shkollat jopublike dhe private mund të marrin pjesë gjithashtu në baza vullnetare.

Cilët studentë bëjnë testin PSSA?

Përveç shumë pak studentëve që plotësojnë kriteret specifike për pjesëmarrje në një test alternativ, të gjithë studentët janë përfshirë në test siç përshkruhet më poshtë:
ELA & Matematikë - Klasat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8
Shkenca—Klasat 5 dhe 8

Kush vendosi se çfarë duhet të masin testimet?

Grupe edukatorësh nga të gjitha nivelet e arsimit në Pensilvani zgjedhën fushat e njohurive dhe aftësive mbi të cilat bazohen testimet. Grupet përfshinin mësues, mbikqyrës, drejtorë kurrikulash dhe specialistë kolegjeshe. Ata gjithashtu shqyrtuan, edituan dhe miratuan artikujt e testit.

Kush i administron testimet?

Çdo shkollë zgjedh personin(at) që do të administrojë testimet. Në shumicën e rasteve, këta janë mësues në shkollën e nxënësve.

Si raportohen rezultatet?

Dy kopje të raportit individual të nxënësve për të gjitha testimet do t'u dërgohen të gjitha shkollave dhe drejtorive që marrin pjesë për shpërndarje tek prindërit, mësuesit, këshilltarët e shkollave dhe/ose drejtorët. Shteti nuk do të marrë asnjë raport me emra individualë të përfshirë. Raportet e nivelit shkollor do të përdoren për qëllime kurrikulare dhe planifikuese. Drejtoria Arsimore dhe shkollat charter mund të publikojnë rezultatet e testimit të PSSA-së për çdo shkollë. Shteti do të nxjerrë gjithashtu të dhënat e testimit nga shkolla në shkollë.

A mund t'i shohin prindërit testimet?

Po, në një rrethanë. Të gjitha shkollave u kërkohet të kenë rregullore për të siguruar që prindërit apo kujdestarët të kenë të drejtë të shikojnë testimin shtetëror në shkollë gjatë orëve të volitshme për prindërit apo kujdestarët nga koha kur materialet e testimit janë marrë deri në ditën e fundit në mënyrë që të përcaktojnë nëse një testim shtetëror bie ndesh me besimin e tyre fetar. Kjo është arsyeja e vetme e lejuar sipas rregullores.

Manuali i Departamentit të Arsimit të
Pensilvanisë për Koordinatorët e Vlerësimit

Marrëveshjet e konfidencialitetit duhet të nënshkruhen dhe asnjë kopje e testimeve apo shënimeve rreth materialeve të testimit nuk do të lejohet të largohet nga shkolla. Nëse pas shqyrtimit të testit, prindërit ose kujdestarët gjejnë që testi është në konflikt me besimin e tyre fetar dhe dëshirojnë që nxënësi i tyre(s) të përjashtohet nga testi, e drejta e prindërve apo kujdestarëve nuk do të mohohet me kërkesë me shkrim drejtuar Superintendent të Drejtorisë, Kryeshefit Ekzekutiv të shkollës charter, ose Drejtorit të AVTS. Prindërit ose kujdestarët duhet të kontaktojnë shkollën e fëmijës së tyre për të bërë takim për të shqyrtuar testin.

Raporto Parregullsitë e Testimit

Prindërit/kujdestarët që besojnë se një parregullsi testimi mund të ketë ndodhur mund të dërgojnë email ra-edirregularities@pa.gov për të raportuar incidentin.

INFORMACION RRETH TESTIMIT TE GJUHËS ANGLEZE DHE ARTEVE (klasat 3 deri në 8)

Sa kohë kërkon testimi?

I gjithë testimi i Gjuhës Angleze dhe Artet merr rreth tre deri në katër orë për t'u përfunduar. Drejtoria Arsimore juaj do t'ju informojë për orarin e testimit.

Çfarë përfshin testimin?

Çdo student plotëson tre seksione pyetjesh për testiimin e arteve të gjuhës angleze. Disa pjesë do të jenë të njëjta për të gjithë studentët dhe disa do të përbëhen nga grupe të ndryshme pyetjesh.

Çfarë lloj pyetjesh janë në testim?

Studentët përgjigjen pyetjeve me zgjedhje të shumëfishta, të bazuara në prova të zgjedhura, të përmirësuara nga teknologjia dhe të ndërtuara me përgjigje. Në një pyetje me zgjedhje të shumëfishta, përgjigja(s) e saktë zgjidhet nga katër opsione. Pyetjet e zgjedhura të përgjigjes të bazuara në prova kanë dy pjesë dhe studentët zgjedhin një ose më shumë përgjigje për secilën pjesë. Pyetjet e përmirësuara nga teknologjia përdorin formate interaktive për t'u lejuar nxënësve të ndërtojnë përgjigje. Pyetjet me përgjigje të ndërtuara mund të përfshijnë një përgjigje të shkurtër (klasa e tretë) ose një analizë bazuar nga teksti (klasa 4 deri në 8). Pyetjet me përgjigje të shkurtra kërkojnë që studentët të formulojnë një përgjigje të shkurtër për të mbështetur përgjigjen e tyre. Për pyetjen e analizës së varur nga teksti, studentët analizojnë një tekst dhe përdorin prova nga pjesa e leximit për të kompozuar një ese(hartim).

Si vlerësohen përgjigjet me shkrim ndaj artikujve të ndërtuar të përgjigjes?

Përgjigjet me shkrim për Artet e Gjuhës Angleze janë vlerësuar nga vlerësuesit e trajnuar në aplikimin e një udhëzuesi për vlerësimin e pikëve specifike të ELA-s. Për pyetjet me përgjigje të shkurtra, rezultatet bazohen vetëm në përmbajtje. Drejtshkrimi dhe shënjat e piksimit nuk përfshihen si pjesë e procesit të vlerësimit.

Përgjigjet ndaj pyetjeve të analizës së varur nga teksti janë vlerësuar bazuar si në përmbajtjen ashtu edhe në aftësitë e shkrimit.

Çfarë vlerësohet në Artet e Gjuhës Angleze?

Vlerësimi i Arteve të Gjuhës Angleze ka gjashtë kategori të mëdha raportimi si dhe dy lloje tekstesh. Studentët u përgjigjen pyetjeve të vetme që vlerësojnë gjuhën. Përveç kësaj, studentët lexojnë një numër pasazhesh nga literatura dhe zhanret informative dhe u përgjigjen pyetjeve rreth këtyre pasazheve që tregojnë si kuptueshmërinë, ashtu edhe aftësitë e leximit, ashtu edhe analizën dhe interpretimin e nxënësve të llojeve të ndryshme të teksteve.

INFORMACION NË LIDHJE ME TESTIMIN NË MATEMATIKË (klasat 3 deri në 8)

Sa kohë kërkon testimi?

I gjithë testimi i matematikës kërkon afërsisht dy deri në tre orë për t'u përfunduar. Drejtoria Arsimore do t'ju informojë për orarin e testimit.

Çfarë përfshin testimi?

Çdo student plotëson dy seksione pyetjesh për vlerësimin e matematikës. Disa pjesë do të jenë të njëjta për të gjithë studentët dhe disa do të përbëhen nga grupe të ndryshme pyetjesh.

Çfarë lloj pyetjesh janë në testim?

Studentët u përgjigjen tri llojeve të pyetjeve: zgjedhja e shumëfishtë, teknologjia e përmirësuar dhe e hapur. Në një pyetje me zgjedhje të shumëfishta, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura. Pyetjet e përmirësuara nga teknologjia përdorin formate interaktive për t'u lejuar nxënësve të ndërtojnë përgjigje. Pyetjet e hapura kërkojnë që studentët të kompozojnë përgjigjet e tyre. Pyetjet “open - ended” në përgjithësi kërkojnë që studentët të japin detaje në mbështetje të përgjigjeve të tyre (si përshkrimi i veprimeve të kryera për të përfunduar një llogaritje).

Si vlerësohen përgjigjet me shkrim të pikëve “open-ended”

Përgjigjet me shkrim për pyetjet “open - ended” të matematikës janë vlerësuar nga vlerësuesit e trajnuar në aplikimin. Një udhëzues për shënimin e pikëve specifike për matematikën. Në matematikë, rezultatet bazohen vetëm në përmbajtje. Drejtshkrimi dhe shënjat e piksimit nuk përfshihen si pjesë e procesit të vlerësimit.

Çfarë vlerësohet në Matematikë?

Vlerësimi i matematikës trajton pesë kategori të mëdha raportimi në katër grupe. Kategoritë raportuese të vlerësuara dhe proporcioni i pyetjeve në çdo kategori raportuese ndryshojnë sipas nivelit të klasës.

Si një pjesë e vlerësimit të Grupit A, numrat dhe veprimet, nxënësit e klasave të 4-ta deri në të 8-tën i përgjigjen një sërë pyetjesh pa makinë llogaritëse (kalkulator). Përgjigjet e pyetjeve konstruktive mund të kërkojnë që studentët të tregojnë të gjithë punën e tyre (p.sh., llogaritjet, grafikët, vizatimet) dhe/ose të shpjegojnë me shkrim se si i zgjidhën problemet.

INFORMACION RRETH TESTIMIT NE SHKENCA (klasat 5 dhe 8)

Sa kohë kërkon testimi?

I gjithë testimi ne shkenca kërkon afërsisht një deri në dy orë për t'u përfunduar. Drejtoria juaj do t'ju informojë për orarin e testimit.

Çfarë përfshin testimi?

Nxënësit e klasave të 5-ta dhe të 8-ta plotësojnë dy seksione pyetjesh për testimin në shkenca. Testimi në shkenca do të përbëhet nga grupe të ndryshme pyetjesh në forma të ndryshme testi.

Çfarë lloj pyetjesh janë në testim?

Studentët u përgjigjen tri lloje pyetjesh: zgjedhja e shumëfishtë, teknologjia e përmirësuar dhe e hapur. Në një pyetje me zgjedhje të shumëfishta, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura. Pyetjet e përmirësuara nga teknologjia përdorin formate interaktive për të lejuar studentët për të ndërtuar përgjigje. Pyetjet e hapura kërkojnë që studentët të kompozojnë përgjigjet e tyre. Klasat 5 dhe 8 mund të përfshijnë edhe skenarë shkencorë.

Çfarë është një skenar shkencor?

Një skenar shkencor përmban tekst, grafikë, tabela dhe i përdor këto elemente për të përshkruar rezultatet e një projekti klase, të një eksperimenti, apo të kërkimeve të tjera të ngjashme. Studentët përdorin informacionin që gjendet në një skenar shkencor për t'iu përgjigjur pyetjeve me zgjedhje të shumëfishta.

Si vlerësohen përgjigjet me shkrim te pyetjeve me fund të hapur?

Përgjigjet me shkrim për artikujt shkencorë me fund të hapur janë vlerësuar nga vlerësuesit e trajnuar në aplikimin e një udhëzuesi specifik të shkencës. Në shkencë, rezultatet bazohen vetëm në përmbajtje. Drejtshkrimi dhe shënjat e piksimit nuk përfshihen si pjesë e procesit të vlerësimit.

Çfarë vlerësohet në shkencë?

Vlerësimi shkencor trajton katër kategoritë kryesore të raportimit: Teknologjia dhe Inxhinieria, Shkencat e Jetës dhe Shkrim-Leximi i Mjedisit dhe Qëndrueshmëria, Shkencat Fizike dhe Shkencat e Tokës dhe Hapësirës. Proporcioni i artikujve në çdo kategori raportuese ndryshon sipas nivelit të klasës.